



- fq. 2** AMF organizoi tryezën e rumbullakët për ndryshimet në Ligjin “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”
- fq. 2** AMF mbështetet nga një grant nga qeveria e Konfederatës Zvicerane

VËSHTRIM MBI TREGJET

- » Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-gusht 2015 fq. 3

ZHVILLIME TË TJERA

- » Seminar rajonal për Solvency II fq. 5
- » Konferenca e 4-t mbi mbikëqyrjen globale të sigurimeve me temë: “Sigurimet, globalisht nën presion” fq. 5
- » Seanca e 48-të plenare e Komitetit Moneyval të Këshillit të Evropës fq. 6
- » Workshop “Mbikëqyrja me bazë riskun” fq. 6
- » Takime të komiteve të Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve në Sigurime, IAIS fq. 7
- » Zhvillohet mbledhja e Komitetit Rajonal të vendeve të Evropës fq. 8

LAJMET NGA RAJONI

- » Çeki fq. 9
- » Maqedoni fq. 9
- » Poloni fq. 10
- » Rumani fq. 10
- » Slloveni fq. 11
- » Turqi fq. 11

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

AMF organizoi tryezën e rrumbullakët për ndryshimet në Ligjin “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”



Gjatë zhvillimit të tryezës së rrumbullakët

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare organizoi në datë 10 shtator 2015, takimim me përfaqësues të shoqërive të sigurimit, Shoqatës së Siguruesve dhe Byrosë Shqiptare të Sigurimit, për diskutimin e ndryshimeve në Ligjin nr. 10 076, datë 12.2.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”. Takimi pati karakter konsultativ, gjatë të cilit u parashtruan komente dhe sugjerime në lidhje me përmirësime apo rregullime të mëtejshme që mund t'i bëhen draftit të përgatitur nga ekspertët e AMF-së.

Ndryshimet në Ligjin nr. 10 076, datë 12.2.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” synojnë t'i japin zgjidhje problemeve që janë hasur gjatë zbatimit të ligjit në praktikë, përshtatjes me zhvillimet dhe kërkesat e tregut të sigurimeve, si dhe përafrimin e mëtejshëm me direktivat evropiane.

AMF mbështetet nga një grant nga qeveria e Konfederatës Zvicerane

Këshilli i Ministrave miratoi në parim, në datë 9 shtator 2015, grantin për fuqizimin e kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. Granti është dhënë nga qeveria e Konfederatës Zvicerane, e përfaqësuar nga Sekretariati Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO). Banka Ndërkombëtare për rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) është administratore e fondeve grant të qeverisë së Konfederatës Zvicerane.

(<http://www.kryeministria.al/al/newsroom/vkm/vendime-te-miratuara-ne-mbledhjen-e-dates-9-shtator-2015>)

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-gusht 2015

Tregu i sigurimeve u rrit me 18.77% gjatë periudhës janar-gusht 2015. Vlera e primeve të shkruara bruto në këtë periudhë arriti rreth 8.96 miliardë lekë. Kjo u shoqërua me rritje të numrit të policave të sigurimit me 7.21% duke arritur në 718,826 polica.

Një tjetër tregues i ecurisë së tregut, dëmet e paguara bruto, në total, regjistruan një rritje me 11.34% në krahasim me periudhën janar-gusht 2014. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto i përket sigurimit motorik me rreth 1.35 miliardë lekë, apo 69.01% të totalit të dëmeve të paguara bruto.

Sigurimi i Jo-Jetës

Sigurimi i Jo-Jetës u rrit me 22.01% gjatë periudhës janar-gusht 2015, krahasuar kjo me periudhën janar-gusht 2014.

Sigurimi i detyrueshëm motorik

Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik vlerësohet të kenë arritur vlerën rreth 5.4 miliardë lekë gjatë periudhës janar-gusht 2015, duke shënuar një rritje prej 22.45% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Sigurimi i detyrueshëm motorik gjatë periudhës raportuese përbën 60.07% të tregut të sigurimeve.

Klasa të tjera në sigurimet e Jo-Jetës

Ndër klasat e tjera kryesore të sigurimit të Jo-Jetës veçohen:


- *Zjarri, forcat e natyrës dhe dëmtime të tjera në pronë të cilat zunë 13.33% të tregut të Jo-Jetës;*
- *Sigurimi i aksidenteve, sigurimi i shëndetit dhe sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme, të cilat së bashku zunë 14.83% të tregut të Jo-Jetës.*

Sigurimi i Jetës

Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës u ulën me 10.05% krahasuar me periudhën janar-gusht të vitit 2014. Pjesa më e madhe e primeve të shkruara bruto i përket sigurimit “Jetë debitori” e cila përbën 64.52% të sigurimit të Jetës.

Ndarja e tregut të sigurimeve, janar-maj 2015

Grafiku më poshtë paraqet ndarjen e volumit total të primeve të shkruara bruto sipas grupeve kryesore.



ZHVILLIME TË TJERA

Seminar rajonal për Solvency II

Qendra e Ekselencës në Financë e Sllovenisë (*Centre of Excellence in Finance, CEF*) në bashkëpunim me Agjencinë e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Sllovenisë (*Slovenian Insurance Supervisory Agency, ISA*) organizuan në Lubjanë, Slloveni më 2 shtator seminarin “Solvency II: Çfarë mund të shkojë keq” (*Solvency II: What can go wrong?*)

Nëpërmjet prezantimeve dhe debateve të eksperteve u evidentuan disa nga problematikat kryesore të lidhura me zbatimin e *Solvency II*. Prezantimet kryesore u bënë nga një grup ekspertësh me përvojë në tregun e sigurimeve dhe autoritete të kësaj fushe si zëvendës Guvernatori i Bankës Qendrore të Sllovenisë, Drejtori i Agjencisë së Sigurimeve të Sllovenisë, Kryetari i Autoritetit Evropian të Sigurimeve dhe Pensioneve (*European Insurance and Occupational Pension Authority, EIOPA*), përfaqësues nga Banka Qendrore e Holandës, Autoriteti Financiar i Anglisë, etj.

Temat kryesore që u trajtuan në seminar ishin:

- » Rreziku që shoqëron zbatimin e *Solvency II*;
- » Qeverisja në regjimin e *Solvency II*;
- » Rreziqet e nga mënyrat e sjelljes në treg.

Pjesëmarrës në seminar ishin mbikëqyrës të tregut të sigurimeve nga rajoni. Nëpërmjet prezantimeve dhe diskutimeve në seminar u pasqyrua mundësia për vlerësimin e riskut dhe menaxhimi e tij, krijimin e strukturave mbikëqyrësve rregullatore mbi bazën e riskun dhe lidhjen e mbikëqyrjes në vend me mbikëqyrjen e pasqyrave financiare, vlerësimi i aftësisë paguese, burimet rregullatore të kapitalit, etj.

Konferenca e 4-t mbi mbikëqyrjen globale të sigurimeve me temë: “Sigurimet, globalisht nën presion”

Qendra Ndërkombëtare për Rregullimin e Sigurimeve (*International Center for Insurance Regulation, ICIR*) në bashkëpunim me Autoritetin e Evropian të Sigurimeve dhe Fondeve të Pensioneve Profesionale (*European Insurance and Occupational Pensions Authority, EIOPA*), Bankën Botërore (*WB*) dhe Universitetin *St. John* të Frankfurtit zhvilluan në datat 8-9 shtator, në Frankfurt, Gjermani, Konferencën e 4-t mbi mbikëqyrjen globale të sigurimeve me temë: “Sigurimet, globalisht nën presion”.

Konferenca u fokusua kryesisht mbi mbikëqyrjen e tregut të sigurimeve në kontekstin global, stabilitetin financiar sipas pikëvështrimit të industrisë dhe rregullatorëve, dinamikën e kalimit nga rregullimi drejt mbikëqyrjes, etj.

Gjatë diskutimeve fokusi ishte në qasjen akademike të mbikëqyrjes financiare të shoqërive mbi raportimin e ndershëm dhe të vërtetë financiar, çështjet dhe sfidat e standardit të kapitalit global, si dhe diskutimi mes dy versioneve: përgatitja për zbatimin e *Solvency II* nga janari 2016 apo mundësia e shtyrjes së hyrjes në fuqi?!

Një sesion ju kushtua mbrojtjes konsumatore nëpërmjet qasjes së bazuar në risk ku diskutuan kryesisht përfaqësues të rregullatorëve për direktivën e re të njohur si “*insurance distribution directive*”, rolin e rregullatorëve, monitorimin e tregjeve dhe marrjen e përshtypjeve të konsumatorëve mbi shërbimet e kompanive të sigurimit me objektivin kryesor për të mbrojtur stabilitetin financiar, konsumatorët dhe aksionarët.

Seanca e 48-të plenare e Komitetit Moneyval të Këshillit të Evropës

Në datat 13-18 shtator, në Strasburg, Francë u zhvillua seanca e 48-të plenare e Komitetit Moneyval të Këshillit të Evropës. Delegacioni Shqiptar përbëhej nga ekspertë të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Bankës së Shqipërisë, Prokurorisë së Përgjithshme, Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, Drejtorisë së Policisë së Shtetit dhe Ministrisë së Drejtësisë.

Më 14 shtator Komiteti mori në shqyrtim raportin e paraqitur nga autoritetet shqiptare për daljen nga procedura e monitorimit të vazhdueshëm dhe bazuar në raportin sugjerimet e sekretariatit të Moneyval vendosën heqjen e vendit tonë nga lista e vendeve anëtare që janë subjekt i këtij procesi.

Nga ana e Sekretarit Ekzekutiv të këtij komiteti u evidentua progresi i bërë nga autoritetet shqiptare për sa i përket përputhshmërisë me kriteret teknike të metodologjisë së FATF, ndërkohë që mbetet për t'u demonstruar efektiviteti i sistemit PPP/FT, në raundin e V-të të vlerësimit që do të fillojë vitin e ardhshëm.

Gjatë kësaj mbledhje u diskutuan dhe raportet e disa vendeve të tjera, si dhe çështje që kishin të bënin me raportet e tipologjive (*FATF, EAG*), prezantimet në kuadrin e procesit të vlerësimeve kombëtare të riskut në fushën e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit nga vendet anëtare të këtij komiteti, statusi i ratifikimit të konventës së Varshavës dhe ecuria e vlerësimit të vendeve anëtare në kuadrin e funksionimit të Konferencës së Palëve.

Workshop “Mbikëqyrja me bazë riskun”

Autoriteti Evropian i Sigurimeve dhe Pensioneve Vullnetare (EIOPA) në bashkëpunim me Bankën Botërore (BB) dhe Autoritetin Austriak të Tregjeve Financiare (FMA), organizuan më 22-23 shtator në Vjenë, Austri *workshop* me temë “Mbikëqyrja me bazë riskun”. Ky *workshop* kryesisht kishte si qëllim t'i ofronte pjesëmarrësve rastin për t'u familjarizuar me procesin e mbikëqyrjes me bazë riskun që po përdoret nga disa autoritete mbikëqyrëse dhe që do të kërkohet në regjimin e *Solvency II*.

Temat kryesore u prezantuan nga përfaqësues të EIOPA-s, BB si dhe drejtues nga autoritete të ndryshme të mbikëqyrjes financiare. Prezantimet lidheshin me:

- » Rëndësinë e mbikëqyrjes me bazë riskun në tregjet e sigurimeve dhe të pensioneve;
- » Kërkesat e direktivës *Solvency II* për siguruesit dhe rregullatorët në kuadrin e mbikëqyrjes me bazë riskun;
- » Mbikëqyrjen e grupeve dhe kolegjet mbikëqyrëse;
- » Eksperiencat e autoriteteve të ndryshme në zbatimin e mbikëqyrjes me bazë riskun.

Pjesëmarrësit në *workshop* u njohën me çështjet që duhet të mbahen në konsideratë gjatë zbatimit të mbikëqyrjes me bazë riskun dhe lidhjet e aktiviteteve të on-site dhe off-site gjatë këtij cikli. *Workshopi* synoi të demonstrojë se në procesin e mbikëqyrjes me bazë riskun, nuk është e mjaftueshme vetëm ndjekja e një liste pyetjesh të njëjta për të gjitha shoqëritë. Kuptimi i karakteristikave të çdo shoqërie bazuar në modelin e biznesit, profilin e riskut dhe cilësinë e riskut material të procesit të menaxhimit të kësaj shoqërie, është një pjesë e rëndësishme e këtij procesi mbikëqyrës.

Në *workshop* gjithashtu u prezantuan eksperiencat dhe sfidat e mbikëqyrësve të autoriteteve të ndryshme, të cilat u fokusuan në aspekte të ndryshme të këtij procesi duke bërë kështu të mundur shkëmbimin e eksperiencave praktike të autoriteteve pjesëmarrëse.

Përfaqësuesit e autoriteteve rregullatore cilësuan si sfida kryesore:

- » Ngritjen e kapaciteteve të stafit në drejtim të njohurive dhe ekspertizës në mbikëqyrjen me bazë riskun;
- » Mbështetjen e kësaj metodologjie mbikëqyrjeje me infrastrukturën e nevojshme;
- » Ndryshimet e nevojshme në bazën rregullatore për të mbështetur metodologjinë e re të mbikëqyrjes dhe zbatimin e Direktivës për *Solvency II*, etj.

Përmes diskutimeve dhe shkëmbimit të informacionit rreth praktikave mbikëqyrëse, EIOPA përpiqet të nxisë zhvillimin e një kulture mbikëqyrëse të njëjtë në vendet e EU-së.

Takime të komiteve të Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve në Sigurime

Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve në Sigurime, IAIS organizoi më datat 16-18 shtator në Bazel, Zvicër takimet e komiteve dhe grupeve të punës së kësaj shoqate. Në këto takime merrnin pjesë përfaqësues nga bankat qendrore, ministritë e financave, autoritetet mbikëqyrëse, dhe rregullatorë të tjerë të tregut financiar nga vende të ndryshme të botës si Franca, Gjermania, SHBA, Japonia, Kina, Italia, BE, Turqia, Maroku, Bermuda, Brazili, etj.

Disa nga takimet e komiteve të shoqatës përfshinin Komitetin e Stabilitetit Financiar, Komitetin Teknik, Komitetin e Buxhetit, Komitetin e Implementimit, Komitetin e Auditit dhe Riskut, Komitetin Ekzekutiv si dhe Grupin e Koordinimit dhe Task Forcën e Metodologjisë GSII.

Gjatë takimeve u diskutuan çështje si: arritja e buxhetit për vitin 2015 dhe planifikimi i buxhetit të vitit 2016, planifikimi i takimeve të ardhshme, logjistika dhe tematikat e takimeve, problematikat e hasura në fushën e sigurimeve si dhe metodologjia e re e vlerësimit të shoqërive të sigurimit me rëndësi sistematike të madhe (*Global Systemically Important Insurance, GSII*).

Zhvillohet mbledhja e Komitetit Rajonal të vendeve të Evropës

Në datën 29 shtator 2015, në Krakov të Polonisë, u zhvillua mbledhja e Komitetit Rajonal të vendeve të Evropës, në kuadrin e komiteteve të IOSCO-s. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare është anëtar me të drejta të plota i këtij Komiteti.

Komitetet rajonale të IOSCO-s shërbejnë si mekanizëm për të koordinuar procesin e vendosjes së standardeve dhe për të rritur komunikimin mes vendeve të rajonit. Objektiv i kryesor i komitetit rajonal është mundësia për të diskutuar mbi risqet emergjente në rajon dhe ndërmarrjen e politikave të përbashkëta dhe çështjeve rregullatore. Mbledhjet e komitetit rajonal synojnë të ndajnë informacionin mes vendeve, anëtare me qëllim rritjen e kapaciteteve rregullatore të çdo vendi anëtar. Mbledhja e 29 shtatorit e përqendroi vëmendjen në disa çështje që lidhen me sjelljen në treg (*market conduct*) dhe rolin e rregullatorit në tregun e FOREX.

Në kuadër të sjelljes në treg, autoriteti anglez paraqiti një përmbledhje të studimit mbi tregjet efektive dhe të drejta në UK, kryesisht mbi tregjet e instrumentave me të ardhura fikse, të valutës dhe të mallrave të quajtura tregjet FICC. Studimi rekomandon vendosjen e standardeve të njëjta mbi praktikën e tregtimit në tregjet FICC, të standardeve të profesionalizmit, ku kërkohet trajnim dhe kualifikim i stafit të tregjeve të FICC dhe rritje e përgjegjshmërisë së operatorëve të tregut dhe individëve, duke rishikuar sanksionet në lidhje me abuzimet e tregut. Gjithashtu, rekomandohet përmirësim në cilësinë, qartësinë dhe kuptimin e praktikave të tregtimit në FICC, forcimin e kuadrit rregullator për tregjet FICC, si dhe nevojën për ndërveprim ndërkombëtar në mënyrë që të rriten standardet në tregjet globale të FICC.

Në lidhje me rolin e rregullatorit në tregun e FOREX, autoriteti polak prezantoi masat ligjore të marra për rregullimin e këtij tregu. Arsyet për rregullim lidhen me rritjen e ndjeshme të tregut të FOREX, përfshirjen e një numri të madh individësh jo-profesionistë në këtë treg, risku tepër i lartë, si dhe levë financiare e lartë. Ky treg është rritur ndjeshëm në kushtet e zhvillimit të platformave elektronike dhe tregtimit online, si dhe marketingut agresiv nga ana e platformave të FOREX. Me synim mbrojtjen e investitorëve përkundrejt levës së lartë të produkteve të tregut FOREX, autoriteti polak shpjegoi hyrjen në fuqi të rregullave të reja në lidhje me kufizimin e levës në tregun derivative të FOREX.

Disa rregullatorë paraqitën eksperiencën e tyre mbi tendencat e zhvillimit të tregjeve financiare dhe perspektivat e së ardhmes. Sekretari i Përgjithshëm i IOSCO-s prezantoi raportin mbi situatën e tregjeve financiare, studimet e ndërmarra, punën e grupeve të punës, nevojën për ngritjen e kapaciteteve, si dhe procesin e nënshkrimit të marrëveshjes multilaterale mes vendeve anëtare të IOSCO-s dhe programin për vitet e ardhshme. Gjithashtu, përfaqësuesi i ESMA-s bëri një prezantim mbi punën një vjeçare, duke përmbledhur fakte dhe të dhëna që flasin për rritjen e rolit të ESMA-s në mbrojtjen e investitorëve dhe promovimin e tregjeve financiare.

LAJMET NGA RAJONI

ÇEKI

www.xprimm.com

Sipas të dhënave të paraqitura nga Banka Kombëtare Çeke, në gjysmën e parë të vitit 2015, tregu çek i sigurimeve pati një rënie prej 5.7% të primet e shkruara bruto (ose një rënie prej 4.99% të shprehur në euro), duke arritur në 78.2 miliardë CZK (Korona Çeke) ose rreth 2.87 miliardë euro. Segmenti i sigurimit të Jetës është krejtësisht përgjegjës për tendencën negative, kryesisht për shkak të rënies së madhe në shitjet e produkteve të sigurimit të Jetës me pagesë totale që në fillim.

Primet e shkruara në sigurimin e Jetës ranë me rreth 16.3% në krahasim me vitin e kaluar, duke arritur në 31.78 miliardë CZK. Në tregun e Jo-Jetës, volumi total i primeve të shkruara bruto u rrit me 3.25% në krahasim me vitin e kaluar e shprehur në monedhën vendase ose 4.02% në euro, duke arritur në 46.43 miliardë CZK ose 1.7 miliardë euro. Segmentet e sigurimit të mjeteve motorike dhe të sigurimit të pronës patën një rritje të përgjithshme në përputhje me mesataren e rritjes së tregut të Jo-Jetës.

MAQEDONI

www.xprimm.com

Sipas shifrave paraprake të publikuara nga Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve ne vend, për periudhën janar-qershor 2015, siguruesit maqedonas raportuan prime të shkruara bruto prej 4.3 miliardë MKD (monedha vendase) ose rreth 70 milionë euro që tregon një rritje prej 8.3% më shumë sesa vitin e kaluar. Ashtu si edhe në periudhat e mëparshme, primet e sigurimit të Jo-Jetës dominuan portofolin e tregut, duke zënë 89.2% të primeve të shkruara bruto në total, nga të cilat rreth 39% ishin kontratat e sigurimit TPL për mjetet motorike, 26.5% lidheshin me produktet e sigurimit të pronës dhe 8.0% ishte sigurimi Kasko për mjetet motorike. Vlera e dëmeve të paguara nga siguruesit gjatë kësaj periudhe u rrit 12.7% duke arritur në 1.5 miliardë MKD ose 25.6 milionë euro.

POLONI

www.xprimm.com

Në krahasim me rezultatet e viteve të kaluara, në gjashtëmujorin e parë të vitit 2015 primet e shkruara bruto u rritën vetëm 1.3% në totalin e tregut duke arritur në 28.09 miliardë PLN (monedha lokale) ose 6.69 miliardë euro. Dëmet e paguara arritën një total prej 17.44 miliardë PLN ose rreth 4.16 miliardë euro.

Sigurimi i Jetës vazhdoi të mbizotërojë me 51.4% të shumës totale të primeve të shkruara bruto të tregut. Shumica e klasave me një përqindje të konsiderueshme në portofolin e sigurimeve të Jo-Jetës patën ndryshime negative në volumin e primeve të shkruara bruto në gjashtëmujorin e parë të vitit 2014. Kategoritë e sigurimit të mjeteve motorike raportuan një volum të përgjithshëm thujse të pandryshuar. Rënia prej 1.44% u regjistrua për primet e shkruara bruto për MTPL, e cila u kompensua thujse plotësisht me rritjen 1.7% në primet e sigurimit Kasko për mjetet motorike. Në të dyja kategoritë, numri i kontratave të lëshuara u rrit me afërsisht 5.5%.

RUMANI

www.xprimm.com

Gjysma e parë e vitit 2015 solli një tendencë rritjeje në tregun rumun të sigurimeve, ku primet e shkruara bruto u rritën me 8.7% në krahasim me vitin e kaluar, duke arritur në 4.3 miliardë RON (monedha lokale) ose rreth 971 milionë euro. Linja e sigurimit MTPL raportoi performancën më të mirë përse i takon rritjes së primeve të shkruara bruto.

Sigurimi i Jetës pati një rritje të përgjithshme të volumit të primeve të shkruara bruto prej 7.5%, në 838 milionë RON ose 188 milionë euro, kryesisht të nxitura nga rritja dyshifrore e arritur për produktet e lidhura me skemat e investimeve.

Në segmentin e sigurimit të Jo-Jetës, primet e shkruara bruto u rritën me 9.02%, duke arritur në 3.48 miliardë RON ose 783 milionë euro, kontributi më i lartë në terma absolute për këtë rritje u siguroa nga kategoria e sigurimeve MTPL.

Një rritje 10% në numrin e shitjeve të automjeteve të reja për pasagjerë, si dhe një rritje prej 23.5% e shitjeve të automjeteve tregtare mbështeti rritjen e primeve të shkruara bruto për MTPL. Në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2015, numri total i kontratave aktive MTPL ishte me rreth 200 mijë njësi më i lartë sesa një vit më parë. Një faktor tjetër nxitës ishte rritja prej rreth 5% e tarifave MTPL. Në sigurimin e pronës pati rezultate të ndryshme, ku primet e shkruara bruto u rritën me 5% në linjën e sigurimit nga zjarri dhe ranë me 2.25% në kategorinë “dëme në pronë”. Dëmet e paguara për kategorinë e sigurimit nga zjarri u rritën gjithashtu me 5%. Përsëri, me një përqindje të kombinuar prej 62%, linja e sigurimit nga zjarri mbetet një nga më fitimprurëset.

SLLOVENI

www.xprimm.com

Pas disa vitesh rënieje të ngadaltë, në gjashtëmujorin e parë të vitit 2015, tregu sloven i sigurimeve u duk se tregoi disa shenja rimëkëmbjeje, me një rritje prej 3.8% në primet e shkruara bruto për sigurimin e Jetës.

Produktet e lidhura me skemat e investimeve ishin nxitëse për sektorin e sigurimit të Jetës, me një rritje prej 9.8% të primeve që tejkaluan rënien 2.5% në primet e shkruara bruto në sigurimin tradicional të Jetës.

Ndryshimet pozitive në primet e shkruara bruto ishin me përmasa shumë modeste në segmentin e sigurimit të Jo-Jetës, ndërsa performanca më e mirë u arrit nga kategoria e sigurimit nga zjarri, e cila pati një rritje prej 2.3% të primeve të shkruara bruto.

Linjat e sigurimit të mjeteve motorike patën përfitime nga rritja e shitjes së autovetura për pasagjerë me 12.7%, por nuk gjetën mbështetje në segmentin e automjeteve tregtare, për të cilin shitjet e njërive të reja u ulën me rreth 3%. Tregu sloven i sigurimeve demonstroi një shkallë të lartë përqëndrimi. Katër siguruesit kryesorë kontrolluan 72.7% të tregut tradicional të sigurimeve, një përqindje e qëndrueshme krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit 2014.

TURQI

www.xprimm.com

Megjithëse, në norma disi më modeste, tregu turk i sigurimeve vazhdoi rritjen e tij konstante edhe në gjashtëmujorin e parë të vitit 2015. Në përgjithësi, primet e shkruara bruto u rritën me 13.4%, duke arritur në 15.04 miliardë TRY (monedha vendase), ndërkohë që, për shkak të rënies së vazhduar të monedhës turke kundrejt euros, rezultatet e tregut të shprehura në monedhën evropiane tregojnë një rritje me 9.6% të primeve të shkruara bruto, duke arritur në vlerën e rreth 5 miliardë euro.

Sigurimi i Jetës, përsëri përbën një pjesë të vogël të portofolit të primeve. Ai raportoi një rritje prej 20.7% në primet e shkruara bruto duke arritur në rreth 625.4 milionë euro.

Sigurimet e Jo-Jetës regjistruan një përqindje të konsoliduar rritjeje prej 12.4%, duke arritur në 4.38 miliardë euro.

Dinamikë më të mirë paraqitën sigurimet e pronës, të cilat patën norma rritjeje dyshifrore të primeve të shkruara bruto. Kategoria e sigurimit nga zjarri regjistroi një rritje prej 12.7% në krahasim me vitin e kaluar. Në total, primet e shkruara bruto për sigurimin e pronës arritën në 4.08 miliardë TRY. Kontratat e detyrueshme të sigurimit nga tërmeti përfaqësuan rreth 54% të numrit total të kontratave të sigurimit të pronës.

Linjat e sigurimit të mjeteve motorike patën një rritje në primet e shkruara bruto prej 6.7%, duke arritur në 5.5 miliardë TRY. Duke marrë në konsideratë autoveturat dhe automjeteve të lehta komerciale, në gjashtëmujorin e parë të vitit 2015 tregu në total u rrit me 50.8% në krahasim me vitin e kaluar. Sipas të dhënave të Shoqatës Turke të Shpërndarësve të Mjeteve Automobilistike, rritja e primeve të shkruara bruto mund të demonstrojë vetëm karakterin mjaft konkurrues të tregut.